

Në bazë të nenit 16, të Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe vendimit të Këshillit Drejtues të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), nr. 969/23, të datës 24.03.2023, Administrata Qendrore e UShAF, me datën 09.06.2023, shpall:

KONKURS

PËR ANGAZHIMIN E STUDENTËVE DHE TË DIPLOMUARVE NË PUNË PRAKTIKE NË ADMINISTRATËN QENDRORE TË UShAF.

I. Titulli i vendit të punës: Praktikantë, 6 (gjashtë) pozita në Administratën Qendrore të UShAF

- 3 (tre) studentë të rregullt në studimet baçelor ose master në UShAF
- 3 (tre) studentë të diplomuar në UShAF në studimet baçelor ose master

1. Dy praktikantë në zyrën e shërbimit të studentëve;
2. Një praktikant në Rektoratin e UShAF;
3. Një praktikant në divizionin për buxhet dhe financa të UShAF;
4. Një praktikant për ndihmë administrative për njësitë akademike të UShAF;
5. Një praktikant për ndihmë administrative në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.

Periodha e angazhimit në punë praktike është për 6 (gjashtë) muaj me pagesë (200 euro bruto në muaj).

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

- Kandidatët për punë praktike duhet të jenë studentë aktual të rregullt në studimet baçelor (viti i dytë dhe i tretë) ose në studimet master (viti i parë dhe i dytë) të UShAF apo të kenë përfunduar studimet baçelor ose master në UShAF;
- Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, do të merret parasysh nota mesatare gjatë studimeve e cila do të jetë përcaktuese në rangimin e kandidatëve.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

- Aplikacionin i cili merret në Administratën e UShAF, Zyra nr. 008

- CV
- Çertifikatën e lindjes origjinale
- Çertifikatën e notave (studentët aktual)
- Vërtetimin e statusit të studentit (studentët aktual)
- Çertifikatën e diplomës ose diplomën për kryerjen e studimeve baçelor ose master, origjinale apo të noterizuar (kandidatët që janë të diplomuar)

Aplikacionet e plotësuara së bashku me dokumentacionin e nevojshëm sipas konkursit, duhet të dorëzohen në formë fizike në zyrën nr. 008 dhe në adresën elektronike në e-mail: info@ushaf.net.

Konkursi mbetet i hapur tetë (8) ditë, përkatësisht nga data 09.06.2023 deri me datën 16.06.2023 në orën 16:00.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë në ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda tri ditëve.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë me konkurs nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur dhe jo të përzgjedhur nga komisioni profesional do të bëhet në Web faqen e Universitetit.

Studentët do të jenë të angazhuar me orar të plotë (08:00-16:00) sipas legjislacionit në fuqi.

Kandidatët që nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 2 (dy) ditësh, në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në kuadër të UShAF.

Ferizaj. 09.06.2023

ADMINISTRATA QENDRORE E UShAF